



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E STANDARDIZIMIT

Nr. ____prot.

Tiranë më ____ . ____ .2023

Lënda: Dërgohet raporti i monitorimit të buxhetit për vitin 2022 me anekset përkatëse

MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORISË SË BUXHETIT DHE MENAXHIMIT FINANCIAR
Tiranë

Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit (DPS), si Organi Kombëtar i Standardeve në Shqipëri, është përgjegjës për organizimin dhe zhvillimin e gjithë veprimtarisë kombëtare të standardizimit, me qëllim plotësimin e nevojave të palëve të interesuara për standarde teknike për të gjitha fushat e ekonomisë.

Misioni i punës së veprimtarisë së standardizimit është të sigurojë plotësimin e nevojave të të gjitha palëve të interesuara (industria/biznesi, tregtia, autoritetet publike, ambientalistët, konsumatorët, SME-të, academia) për standarde teknike bashkëkohore në të gjitha fushat e ekonomisë, në mbështetje të konkurrueshmësisë dhe reduktimit të Barrierave Teknike në Tregti.

Qëllimi është të rrisë nivelin e sigurisë së produkteve dhe proceseve, në mbrojtje të shëndetit e jetës së personave, kafshëve si dhe mjedisit.

Këto janë materializuar edhe ndërmjet qëllimit të programit 04160, i cili është: Mbështetje për mbikqyrjen e tregut, infrastrukturë cilësie dhe pronësi industriale

Për përmbushjen e sa më sipër, objektivat e DPS janë:

- Të përafrojnë legjislacionin kombëtar me legjislacionin evropian dhe rregulloret evropiane të standardizimit (ETSI, CEN&CENELEC) dhe ndërkombëtare (ISO dhe IEC).
- Të zbatojë dhe rishikojë të gjithë paketën ligjore për proceset e integritetit në fushën e standardizimit.
- Të organizojë dhe drejtojë punën për progresin në adaptimin e standardeve evropiane dhe informimin e ndërgjegjësimin e operatorëve ekonomikë dhe palëve të interesuara për rëndësinë e standardeve
- Të mirëadministrojë Sistemin e Menaxhimit të Standardeve (SMS), shitjen e tyre dhe mirëfunksionimin e Autoritetit Kombëtar të Notifikimit dhe Pikës së Referimit në OBTA dhe CEFTA.
- Të funksionojnë sa më mirë strukturat e DPS (Bordi Drejtues, Bordi Teknik dhe Komitete Teknike)

Nëpërmjet këtij relacioni, si dhe formateve bashkëlidhur, informojmë mbi objektivat, treguesit e performancës në nivel qëllimi, objektivi si dhe produktet e realizuara, në sasi e vlerë, për vitin 2022.

Produktet sipas Programit : Mbështetje për mbikqyrjen e tregut,infrastrukturë cilësie dhe pronësi industriale me kod 04160, janë Standarde evropiane dhe ndërkombetare të adaptuara, miratuara si SSH si dhe Shitja e Standardeve.

1. Adoptimi i standardeve evropiane e ndërkombëtare si Standarde Shqiptare (SSH)

Në kuadër të aplikimit të Sistemit të Ri të Menaxhimit të Standardeve, si dhe në mbështetje të VKM-së Nr. 382 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e standardizimit” e cila është amenduar në muajin Nëntor të vitit 2021, DeS ka përgatitur programin e punës një vjeçar, sipas të cilit adoptimi i standardeve dhe i dokumenteve të standardizimit është shtrirë në periudhën **Maj-Dhjetor 2022**.

Parashikimi për vitin 2022 ishte të adoptohen si standarde shqiptare (SSH) gjithsej 1,710 standarde sipas programit të punës së Drejtorisë së Standardeve. Fakti është që janë adoptuar 1,828 standarde evropiane dhe ndërkombëtare, me një realizim 107 %, të detajuara si në tabelën 1.

Tabela 1 Adaptimi i standardeve evropiane e ndërkombëtare si SSH për vitin 2022

Nr.	EMËRTIMI	PLAN	Fakt	Realizimi në %
1	Standarde të adaptuara (CEN/CENELEC)	900	953	105 %
2	Standarde të ETSI	380	384	101 %
3	Standarde të ISO/IEC	430	491	114 %
	Totali	1,710	1,828	107 %

Siç thamë dhe më lart gjatë këtij viti janë adoptuar rreth 1,828 standarde dhe dokumente standardizimi si Standarde Shqiptare (SSH) dhe Dokumente Standardizimi Shqiptare (DS); nga ku 1,016 në fushën e elektroteknikës dhe telekomunikacionit - Sektori CENELEC/IEC/ETSI dhe 812 standarde nga të gjitha fushat e ekonomisë – Sektori CEN/ISO. Pjesa më e madhe janë standarde me origjinë evropiane, rreth 1,337 standarde (CEN, CLC dhe ETSI) dhe 491 standarde ndërkombëtare (ISO dhe IEC); Fushat ku Komitetet Teknike kanë pasur numër më të madh adoptimesh janë si më poshtë:

- Analizat e produkteve ushqimore;
- Eurokodet strukturore;
- Sporte dhe sheshe lojërash;
- Cilësia e ujit, ajrit dhe tokës;
- Pajisje mbrojtëse personale;
- Pajisje mjekësore;
- Pigmente, Shpërndarës dhe Bojëra;
- Siguria teknike dhe mjedisi;
- Sistemet e telekomunikacionit analoge dhe dixhitale;
- Materiale elektrike dhe elektronike.
- Janë shfuqizuar rreth 233 standarde (169 me origjinë evropiane dhe 64 me origjinë ndërkombëtare) sipas fushave të caktuara dhe Komiteteve Teknike përkatëse, duke ndjekur “ciklin e jetës” së standardit.

- Janë adoptuar 100% standardet e harmonizuara nën Direktivat përkatëse si dhe është realizuar përditësimi dhe rifreskimi i listave të tyre nga Sekretarët e KT-ve.
- Janë adoptuar rreth 77 standarde me procedurë të përshpejtuar sipas kërkesave të klientëve, palëve të interesuara (biznese, institucione, laboratore, persona fizikë) kryesisht në fushat si më poshtë: - Cilësia e ujit, ajrit dhe tokës; - Fruta dhe perime të freskëta; - Vajra dhe yndyrna ushqimore - Fara vajore; - Plastika; - Siguria teknike dhe mjedisi; - Pajisje elektrike dhe elektronike.

2. Përafrimi i legjislacionit kombëtar me legjislacionin evropian dhe rregulloret evropiane të standardizimit (ETSI, CEN&CENELEC) dhe ndërkombëtare (ISO dhe IEC). Objektivi është të zbatojë dhe rishikojë të gjithë paketën ligjore për proceset e integritimit në fushën e standardizimit. Në këtë kuadër punohet për evidentimin e të rejave sipas situatës në fushën e standardizimit.

3. Promovimi dhe publikimet

Gjatë kësaj periudhe janë përkthyer dhe publikuar në faqen e web-it dhe në rrjetet sociale të DPS, Facebook, LinkedIn, Twiter gjithsej **29** Artikuj me titujt:

1. Rritja e pjesëmarrjes së femrave në kërkimin shkencor
2. Ekonomia e ndarjes dhe tregtia elektronike ofrojnë stabilitet ndërkombëtar
3. Ndryshimet shoqërore që formësojnë të ardhmen tonë
4. Mbajtja e premtimit për një mjedis të gjelbër
5. Avancimi i barazisë gjinore krijon një botë të qëndrueshme
6. Rrjetet sociale dhe menaxhimi i situatave të vështira
7. Komiteti Evropian për Standardizimin (CEN) dhe Komiteti Evropian për Standardizimin në fushën e elektroteknikës (CENELEC) njoftojnë mbajtjen e konferencës për standardizimin e legjislacionit të sigurisë kibernetike në Bashkimin Evropian
8. Ndërtimi i një të ardhmeje më të shëndetshme për të nesërmen
9. Të hash si vendasit
10. Komiteti Evropian për Standardizimin (CEN), sapo ka publikuar specifikimet e reja teknike për produktet plehëruese duke u bazuar në objektivat e ekonomisë rrethore të BE
11. Komiteti Evropian për Standardizimin (CEN) dhe Komiteti Evropian i Elektroteknikës për Standardizimin (CENELEC) kanë krijuar një hartë të re për standartet evropiane, të cilat mbështesin Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara (SDGs)
12. Organizata Ndërkombëtare për Standardizimin (ISO) sapo ka publikuar një udhëzues të ri për testimin e COVID-19
13. Konsumatorët e pambrojtur
14. E ardhmja e kujdesit shëndetësor
15. Ushqim i sigurt, shëndet i mirë dhe një e ardhme e shkëlqyer
16. Ti mbajmë të sigurtë zjarrëfikësit
17. Ekonomia e re bazohet në projekte
18. Tendencat në zhvillimin e llojeve të turizmit
19. Dita Ndërkombëtare e Standardeve për vitin 2022
20. Të ruajmë ekosistemet natyrore
21. Organizimi i trajnimit të thelluar të stafit të DPS në lidhje me kërkesat e standardit SSH EN ISO 9001:2015
22. Organizata Ndërkombëtare për Standardizimin (ISO) sapo ka publikuar standardin për sigurinë e sistemeve të informacionit ISO/IEC 27001

23. Dita Botërore e Standardeve 2022
24. Java e dedikuar për vazhdueshmërinë e prodhimit të energjisë nga BE për vitin 2022
25. Mbështetja ndaj moshës së tretë
26. Memorandum bashkëpunimi ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit dhe Institutit për Standardizim të Republikës së Maqedonisë së Veriut (ISRSM)
27. Një erë e re për shëndetin mendor në punë.
28. Pandemia COVID-19 ka ndikuar në shëndetin emocional dhe mendor të punonjësve.
29. Çisterna për transportin e mallrave të rrezikshme - Ndërfaqja dixhitale për transferimin e të dhënave ndërmjet autoçisternës dhe strukturave të pa lëvizëshme, pajisjet elektronike të cilat përdoren në transportin e mallrave të rrezikshme

Publikuar 99 ekstrakte standardesh të fushave:

Pajisje elektroshtëpiake; Pajisje inxhinierike; Materiale ndërtimi; Produkte ushqimore; Kimia; Sporti; Mjekësia; Siguria ushqimore; Siguria e lodrave; Artikuj për fëmijë; Pajisje mbrojtëse personale; Lëndë djegëse; Artikuj për fëmijë; Pajisje për pishina; Sisteme alarmi; Trafiku rrugor; Turizmi; Materiale për paketim; Lëndë drusore; Makineri përpunimi; Ndriçimi; Makina dhe traktorë në bujqësi

Janë publikuar 3 Buletine, përkatësisht:

- Buletini Nr. 90, Buletini Nr.91 dhe Buletini Nr. 92.
- Janë organizuar dy mbledhje të bordit teknik dhe dy mbledhje të bordit drejtues.
- Janë organizuar 2 aktivitete promovuese mbi rolin dhe rëndësinë e standardeve në infrastrukturën e cilësisë, në qytetin e Gjirokastrës dhe në qytetin e Korçës, në kuadër të kalendarit të aktiviteteve promovuese të miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Standardet më të shitura janë të fushave:

- Produkte naftë, lubrifikantë, qymyre dhe produkte që lidhen me to
- Agregate dhe muraturë
- Analizat e produkteve ushqimore. Materialet në kontakt me ushqimin

Realizimi i Treguesve ekonomik-financiare (Aneksi 2)

Buxheti vjetor i akorduar për DPS, konsiston në mbështetjen logjistike të ushtrimit të kompetencave e funksioneve të institucionit, për arritjen e objektivave të caktuara. Gjatë vitit kemi pasur disa rialokime të fondeve buxhetore dhe buxheti vjetor i rishikuar i institucionit rezulton i alokuar për paga 47%, sigurime 8 %, shpenzime operative 17%, pagesë të kuotave ndërkombëtare 27%, dhe transferta në individë e familje 1 % (Tabela 2).

Buxheti i planifikuar për vitin 2022 pas reduktimeve me aktet normative ishte **29,829** dhe realizuar **27,987 mijë lekë** ose **94%** (tabela 3).

Table 2 Plani buxhetor 2022 dhe % e zërave të shpenzimeve kundrejt totalit

Në mijë lekë

Nr.	EMËRTIMI	PLANI BUXHETOR 2022	NË % NDAJ TOTALIT
1	Paga	14.000	47 %
2	Sigurime shoqërore	2.500	8 %
3	Mallra e shërbime të tjera	4.960	17 %
4	Transferta Korente të Huaja	8.040	27 %
5	Transferta tek individët dhe familjet	288	1 %
6	Investime	40	0 %
	Totali	29,828	100%

- **Fondi i përgjithshëm i pagave dhe i sigurimeve shoqërore (600-601)**, është realizuar për numrin faktik të punonjësve respektivisht në vlerën **16,025 mijë lekë** për paga ose pothuaj **97 %** e fondit të planifikuar të shpenzimeve prej **16,500 mijë lekë**. Stafi i DPS nuk është i plotë pasi janë larguar 2 punonjës dhe aktualisht kemi 13 nëpunës civilë, 1 punonjës administrativ dhe 1 punonjës me kontratë. Në muajin shtator patëm rritje rrogash mesatarisht 7% dhe në fund të vitit punonjësit u kompensuan nëpërmjet ndihmës së menjëhershme financiare për zbutjen e efekteve të krizës.

Në tabelën e mëposhtme, pasqyrohet realizimi në % dhe vlerë, i secilës kategori shpenzimesh, përkundrejt buxhetit të akorduar.

Table 3 Realizimi i fondeve buxhetore viti 2022 në vlerë dhe %

Në 000 / lekë

Nr.	EMËRTIMI	PLAN	FAKT	REALIZIMI NE %
1	Paga	14,000	13,722	98 %
2	Sigurime shoqërore	2,500	2,303	92 %
3	Mallra e shërbime të tjera	4,960	3,673	74 %
4	Transferta Korente të Huaja	8,040	8,040	100 %
5	Trans per Buxh. Fam. & Individ	288	208	72 %
6	Investime	40	40	100 %
	Totali	29,828	27,987	94 %

- **Fondi për Shpenzime Korrente të tjera (602-606)**, për vitin 2022 është realizuar në vlerën **3,673 mijë lekë**, nga **4,960 mijë lekë të planifikuara** ose rreth 74 % e fondit të planifikuar tek 602. Ky fond është përdorur për:

- Shlyerjen e detyrimeve ndaj të tretëve, si detyrime energji elektrike, ujë, shërbime bankare, postare e telefonike.
 - Shpenzime për transfertat korrente të huaja, të cilat janë pagesa të kuotizacioneve të organizmave evropiane e ndërkombëtare, në të cilat DPS bën pjesë
 - Shpenzime për buxhetet familjare dhe individë
- **Fondi për shpenzime investime (zëri 230, 231)**, ku vlera e planit vjetor të fondit të investimeve ishte 2,000,000 lekë në fillim të vitit, pastaj u reduktua në 1,000,000 leke dhe në fund të vitit mbeti 40,000 lekë, e cila bëri që investimet të jenë realizuar 100%.

Në **Aneksin nr. 3** është paraqitur realizimi i treguesve të performancës/produkteve (në sasi dhe vlerë) në zbatim të objektivave për vitin 2022, adaptim dhe shitje standardesh.

➤ **Të ardhurat nga Shitja e standardeve**

Për vitin 2022 janë shitur gjithsej **586** standarde, dhe të ardhurat e realizuara në vlerë janë **1.496.693** lekë.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

RIZA HASANAJ